

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA QYTET SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Shoqërinë SHA Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 169 datë 16.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 1189/6 datë 26.02.2014, dërguar z. Leonard Kepi, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në Ujësjellës Kanalizime SHA Qytet Shkodër ka rezultuar se, në vendimet e Drejtorit të shoqërisë të marra për periudhën 01.06.2012-30.06.2014 mungon baza ligjore, konceptuesi dhe rezultojnë kapërcime të numrave të këtyre vendimeve, si dhe nuk janë të arkivuara, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” (trajtuar më hollësisht në faqet 13-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë të marrë masa për administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe Modelit nr. 8 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjiksë së shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. Asambleja e Aksionarit në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, është mbledhur vetëm një herë.

-Këshilli Mbikqyrës nuk ka funksionuar për periudhën 01.06.2012-29.03.2013.

-Kryetari i këshillit mbikqyrës, ka marrë dy vendime pas përfundimit të mandatit ligjor.

-Në 2 raste këshilli mbikqyrës, ka marrë vendime që tejkalojnë kompetencat.

-Për periudhën 15.02.2013-15.04.2013, drejtori i shoqërisë ka funksionuar pa mandat ligjor, pasi është emëruar nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të cilëve u ka përfunduar mandati (trajtuar më hollësisht në faqet 13-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të marrin masa për thirrjen e Asamblesë së Aksionarit të paktën njëherë në vit dhe të nxjerrë përgjegjësitë për vendimet e marra nga Këshilli Mbikqyrës në tejkallim të kompetencave si dhe atyre vendimeve që janë marrë pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Menjëherë dhe Vazhdimisht

3. Për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, Drejtoria e Shoqërisë në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, nuk ka hartuar dhe dërguar për miratim në Asamblesë së Aksionarit, programin ekonomiko-financiar (trajtuar më hollësisht në faqet 17-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtorja e shoqërisë të hartojë, miratojë dhe të dërgojë në institucionet eprore programe ekonomiko-financiar me tregues të harmonizuar dhe të bashkërenduar, duke ndjekur të gjitha

fazat përkatëse, si dhe periodikisht të analizojë ecurinë e tyre, duke përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe realizmin e tyre.

Vazhdimisht

4. Llogaritja e prodhimit të ujit nga departamenti i ujësjellësit dhe departamenti i planifikimit rezulton me diferencë, për rrjedhojë është raportuar 12,724,199 m³ ujë më pak si dhe norma teknike e humbjeve në rrjet është raportuar 68% nga 79% (trajtuar më hollësisht në faqet 17-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e shoqërisë, Departamenti i Ujësjellësit dhe Departamenti i Planifikimit, të marrin masa për përcaktimin e mënyrës së llogaritjes së prodhimit të ujit, për raportimin e saktë të prodhimit mujor si dhe korrigjimin e treguesve statistikorë në funksion të analizave për raportet prodhim-faturim-arkëtim uji.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

5. Shoqëria UK Shkodër nuk ka hartuar rregulloren mbi rekrutimet e punonjësve, në rekrutimet e reja konstatohet se nuk ka një përshtatje të detyrave funksionale me arsimin përkatës, tejkallim i strukturës organike, e cila ka sjellë një efekt financiar negativ në vlerën 1,413,006.86 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 24-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të analizojnë me përgjegjësi numrin dhe strukturën organike të miratuar dhe të zbatuar, duke nxjerrë përgjegjësinë për tejkallimet e numrit të fuqisë punëtore me efekt financiar 1,413,006.86 lekë, të hartojnë nivele pagash për vende pune me të gjithë elementët përbërës (arsimi, përvoja etj.), si dhe fond pagash sa më real, si një nga zërat e shpenzimeve me peshë të konsiderueshme në koston e furnizimit me ujë.

Brenda datës 31.03.2015

6. UK Shkodër nuk ka miratuar pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2012 dhe 2013 në Asamblenë e Aksionarit, si dhe konstatohen pasaktësi në kontabilizimin e detyrimit për tvsh, për tatimin mbi fitimin, detyrimet për gjobat dhe interesat, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (trajtuar më hollësisht në faqet 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës, Drejtoria e Shoqërisë dhe Departamenti i Financës të marrin masa për miratimin e pasqyrave financiare në Asamblenë e Aksionarit, saktësimin e të dhënave dhe rakordimin me organet tatimore, për kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë, të detyrimeve fiskale, të gjobave dhe interesave përkatëse.

Brenda datës 31.12.2014 dhe Vazhdimisht

7. Drejtoria e Shoqërisë nuk ka kryer analizë të hollësishme mbi gjendjen e debitorëve nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit ndaj subjekteve debitore nuk i është paraqitur për analizë të mëtejshme Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionarit në kundërshtim me Ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (trajtuar më hollësisht në faqet 30-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë, të analizojnë gjendjen e debitore, të marrin masat e nevojshme të menjëhershme për reduktimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, në zbatim të Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

8. UK Shkodër nuk ka hartuar regjistër kontabël të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike, si dhe të gjitha objektet që në kontabilitet janë regjistruar në “Zërin troje” nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 33-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e shoqërisë, Departamenti i Menaxhimit të Aseteve dhe Departamenti i Financës, të marrin masat për krijimin e regjistrit kontabël të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, kryerjen e inventarizimit vjetor me qëllim evidentimin e saktë të aktiveve, nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse për diferencat e konstatuara në magazinë, si dhe regjistrimin e objekteve të cilat në kontabilitet janë pasqyruar në “Zërin troje”, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër.

Brenda datës 31.12.2014

9. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për tenderat e audituar kanë rezultuar mangësi që kanë të bëjnë me s`kualifikim operatorësh me arsyetimin e mosparaqitjes së ofertës ndërkohë që në sistemin elektronik rezulton e paraqitur, janë kualifikuar operatorë me dokumentacion më të hershëm se përcaktimet e DST, është s`kualifikuar për mungesë dokumentacioni një operator ekonomik ndërkohë që në procedurën e dytë është kualifikuar me të njëjtin dokumentacion, KVO nuk kishte në përbërje specialistë të fushës, specifikimet teknike të mallit të lëvruar ndryshonin me ato në kontratë, kushtet e përgjithshme të kontratës nuk janë të nënshkruara në të gjitha fletët nga titullari i autoritetit kontraktor, titullari i autoritetit kontraktor nuk ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim, operatorët ekonomikë fitues i kanë sjellë dokumentet dorazi, si dhe nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 37-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e shoqërisë, t`i kushtojë vëmendje e duhur procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga komisionet e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, për ngritjen e komisionit të pranimit dhe kolaudimit të materialeve dhe pajisjeve, në zbatim të kontratave respektive të prokurimeve, për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit origjinal të operatorëve ekonomikë, si dhe për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca e nevojshme.

Vazhdimisht

10. Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë specifikimi i saktë i mallrave dhe i materialeve që janë prokuruar, nuk janë dhënë detaje teknike të plota, nuk është argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve, si dhe për grup mallrat e ngjashme është tejkaluar limiti ligjor prej 400.000 lekë. Për pasojë duhet të ishin zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit.

Në 4 (katër) raste, procedura e blerjes me vlerë të vogël, nuk kishte dokumentacionin e plotë vërtetues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 6 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012, “Për blerjet me vlera të vogla” i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 57-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Shoqërisë të marri masa, që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën me një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

Vazhdimisht

11. Nga titullari i institucionit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nuk janë nxjerrë urdhra të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, administrimin, përdorimin e karburantit, nuk janë ngritur komisionet për matjen e konsumit të karburantit për çdo mjet si dhe nuk janë mbajtur kartela për shërbimet e kryera nga këto mjetet (trajtuar më hollësisht në faqet 60-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i shoqërisë të ngrihen komisionet për matjen e konsumit të naftës nga mjetet në përdorim, të nxirren urdhrat për administrimin dhe përdorimin e naftës, si dhe të merren masa për mbajtjen e kartelave për shërbimet e kryera, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

12. Drejtoria e Shoqërisë, nuk ka të implementuar në strukturat e saj, njësinë e auditit të brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 63-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e shoqërisë, të marri masa për ngritjen e strukturës së Auditit të Brendshëm, në përputhje me Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Brenda datës 31.12.2014

13. UK Shkodër, nuk disponon udhëzim rregullativ të shkruar lidhur me zbatimin e ligjit për Menaxhimin Financiar, në lidhje me përcaktimin e strukturave menaxheriale, përcaktimin e nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse si dhe linjat e raportimit, si dhe kriteret e kryerjes së shpenzimeve, niveli i kompetencave dhe i autorizimit të pagesave, nuk janë të vendosura në rregullore të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës (trajtuar më hollësisht në faqet 63-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtori i Shoqërisë, të rishikohet rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të shoqërisë, të bëhen rregullimet e nevojshme ku të jenë të implementuara sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm.

Brenda datës 31.03.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Për periudhën 01.06.2012-30.11.2012, është kryer pagesa për Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës në vlerën **138,510 lekë**, pas përfundimit të mandatit, në kundërshtim me Ligjin nr.

9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (trajtuar më hollësisht në faqet 60-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **138,510 lekë**, përfituar nga [REDAKTUAR], si shpërblim për kryerjen e detyrës së Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës, pas përfundimit të mandatit në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

2. Nga sondazhi i kryer për dokumentimin dhe administrimin e vlerave materiale, në magazinë më datë 23.09.2014, nga përzgjedhja e gjashtë artikujve, në tre prej tyre u konstatua diferencë ndërmjet gjendjes kontabël dhe asaj fizike në vlerë **85,400 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 33-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **85,400 lekë**, nga [REDAKTUAR], si përgjegjës për diferencën midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike në magazinë.

Menjëherë

3. Në 11 raste, u konstatua se janë kryer shpenzime për udhëtime e dieta në **vlerën 127,400 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” (trajtuar më hollësisht në faqet 60-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **127,400 lekë**, përfituar në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, nga personat sipas Aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

4. Nga llogaritja e fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 708, datë 12.10.2011 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, për tenderin e zhvilluar me objekt “Blerja dhe furnizimi me materiale ndërtimi për vitin 2012, Loti 1”, u konstatua dëmi ekonomik në vlerë **88,800 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 37-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **88,800 lekë**, nga anëtarët e njësisë së prokurimit: [REDAKTUAR], për rritje fiktive të fondit limit në procedurën e prokurimit “Blerje dhe furnizim me materiale ndërtimi”, të zhvilluar në vitin 2012.

Menjëherë

5. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Furnizimi me prodhime betoni i SHA Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër”, operatori fitues “[REDAKTUAR]”, ka lëvruar kontratën me 101 ditë vonesë, në kundërshtim me gërmën b, neni 24.1 të kontratës, për të cilën duhet të llogaritej kamat-vonesa me vlerë **131,097.19 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 39-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **131,097.19 lekë**, nga operatori ekonomik "██████", si penalitet për lëvrimin e vonuar të mallit, në kundërshtim me kushtet e kontratës.

Menjëherë

6. Është kryer pagesa për operatorin ekonomik "██████", me **vlerë 280,080 lekë**, për lyerjen dhe pastrimin e ambienteve të brendshme, pa dokumentacionin vërtetues si urdhër prokurimi, preventivë dhe kolaudim të punimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 6, Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012,"Për blerjet me vlera të vogla" i ndryshuar, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" (trajtuar më hollësisht në faqet 57-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **280,080 lekë** nga operatori ekonomik "██████", për punime të pakryera në lyerje dhe pastrim të ambienteve të brendshme, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 6, Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012,"Për blerjet me vlera të vogla" i ndryshuar, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

Menjëherë

7. Janë kryer pagesa në shpenzime për organizim drekë pune, me **vlerë 101,180 lekë**, pa dokumentacion vërtetues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 6, dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012,"Për blerjet me vlera të vogla" i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 57-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **101,180 lekë**, si përfitim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përkatësisht nga ██████ vlera **31,200 lekë** dhe ██████ vlera **69,980 lekë**.

Menjëherë

8. Është paguar ██████ për blerje me vlera të vogla kalendarë **vlerë 35,000 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 6, dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012,"Për blerjet me vlera të vogla" i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 57-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **35,000 lekë**, nga ██████, si përfitim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 6, dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012,"Për blerjet me vlera të vogla" i ndryshuar.

Menjëherë

9. Drejtoria e Shoqërisë ka paguar shpërblime për punonjësit e saj në listë-pagesat e muajit Dhjetor 2012, për vlerën **2,425,910 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për UK Shkodër (trajtuar më hollësisht në faqet 24-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,425,910 lekë**, nga punonjësit e shoqërisë në listë-pagesat e muajit Dhjetor 2012, si përfitim në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në pikën 3 të nenit 16 të Statutit tip, të miratuar me VKM nr. 678, datë 3.10.2007 “Për një shtesë në Vendimin nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”, i propozojmë Këshilli Bashkiak Shkodër, në cilësinë e Aksionarit të Vetëm të SHA “Ujësjetllës Kanalizime Qytet Shkodër”, dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga detyra”

për:

1. ■■■■■, me detyrë Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, pasi:

-Nuk ka marrë masa për ri-emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe për delegimin e çështjes tek Asambleja e Aksionarit, duke e lënë shoqërinë për periudhën 10.10.2011-29.03.2013 pa këshill mbikëqyrës, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 134 “Organet dhe publikimi”, pika 1, gërma c.

-Ka marrë Vendimin nr. 2/1, datë 28.06.2012 në zbatim të Ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, pasi i ka mbaruar mandati i tij ligjor si kryetar i këshillit mbikëqyrës, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 135, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 9, si dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 14.

-Ka marrë Vendimin nr. 4, datë 30.06.2014, numër protokollit 12 “Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2013 të Ujësjetllës Kanalizime Qytet Shkodër”, në tejkallim të kompetencave, pasi miratimi i pasqyrave financiare kryhet nga Asambleja e Aksionarëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 81.

-Nuk ka ndjekur procedurën e hartimit të programit ekonomik-financiar nga stafi i UK Shkodër, si dhe nuk e ka dërguar për miratim Asamblesë së Aksionarit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 154.

-Ka marrë Vendimin nr. 1, datë 15.02.2013 “Për emërimin e ■■■■■ Drejtor i UK Shkodër”, pasi i ka mbaruar mandati i tij ligjor si kryetar i këshillit mbikëqyrës, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 135, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 9, si dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 14.

-Nuk ka thirrur mbledhjen e Asamblesë së Aksionarit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 136, pika 2.

-Nuk ka dërguar për miratim Asamblesë së Aksionarit, pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 81.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-24 dhe 30-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 1 dhe 2, datë 30.09.2014)

II. Mbështetur në nenet 37, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në kontratën individuale të punës, dhënien e masës disiplinore:

Neni 11, paragrafi 3 “Paralajmërim për pushim nga puna”

Për,

1. ████████, me detyrë specialist i aseteve, pasi:

-Nuk ka kryer asnjë detyrë funksionale sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 5 datë 30.09.2010, e ndryshuar me Rregulloren nr. 3, datë 10.03.2014, paragrafi 1.

-Nuk ka hartuar një regjistër kontabël të aktiveve që UK Shkodër zotëron apo ka në administrim, si dhe nuk ka evidentuar numrin e saktë të aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33, si dhe vendimet nr. 4, datë 17.02.2014 dhe nr. 3, datë 10.03.2014, të këshillit mbikqyrës.

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka kryer menaxhimin e vlerave materiale, inventarizimin, nxjerrjet jashtë përdorimit dhe asgjësimin, në kundërshtim me në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe vendimet nr. 4, datë 17.02.2014 dhe nr. 3, datë 10.03.2014, të këshillit mbikqyrës.

-Për vitin 2012 nuk ka kryer procedurën e inventarizimit, në kundërshtim me Urdhrin nr. 3 datë 03.01.2012 të Drejtorit të UK Shkodër.

-Nga sondazhi i kryer në magazinën e UK Shkodër, më datë 23.09.2014, për dokumentimin dhe administrimin e vlerave materiale, u konstatua se gjendja kontabël nuk përkonte me gjendjen fizike.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 5, 16 dhe Aktverifikimin nr. 4, datë 30.09.2014)

2. ████████, me detyrë Shefe e Departamentit të Planifikimit, pasi:

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka hartuar si dhe nuk ka dërguar për miratim tek Këshilli Mbikqyrës, programe ekonomiko-financiare vjetore.

-U konstatuan diferenca në mënyrën e llogaritjes së prodhimit të ujit ndërmjet departamentit të ujësjellësit dhe departamentit të planifikimit. Nga këto diferenca, rezulton se për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, ka raportuar më pak 12,724,199 m³ ujë, si dhe ka raportuar normën e humbjeve teknike në vlerën 11% më pak, e cila duhet të jetë 79% dhe jo 68% e raportuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës e Kanalizime (DPUK) dhe Institutin e Statistikave (INSTAT).

-Të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, nuk janë të miratuara në programin ekonomiko-financiar të vitit 2012, për shkak se për vitet 2012, 2013 dhe 2014, nuk janë hartuar programe ekonomiko-financiare, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, si dhe në disa raste ato kanë qenë të sforcuara. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet operatorët ekonomikë fitues, i kanë sjellë dokumentet dorazi dhe të paprotokolluara apo arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22 “Format e Komunikimit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-24 dhe 49-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 2, 11, 12 dhe 13, datë 30.09.2014)

3. [REDAKTUAR], me detyrë Shefe e Departamentit të Financës, pasi:

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka hartuar si dhe nuk ka dërguar për miratim tek Këshilli Mbikqyrës, programe ekonomiko-financiare vjetore.

-Nuk ka miratuar pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2012 dhe 2013, në Asamblenë e Aksionarit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 81.

-Nuk ka kontabilizuar të plotë detyrimin për tvsh dhe tatim-fitimin, si dhe nuk ka kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare, detyrimet për gjoba të vendosura nga organet tatimore dhe interesat e detyrimeve të prapambetura, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

-Në tenderin “Blerje dhe furnizim me Kapakë Gize” nga KVO u konstatua se një operator ofertues nuk kishte paraqitur ofertë ekonomike, ndërsa nga auditimi i procedurës elektronike, rezultoi se ky operator kishte paraqitur ofertë, por që nuk ka efekt financiar pasi ishte më e lartë se oferta fituese.

-Në tenderin “Blerje dhe furnizim me Eurodiesel i sektorit KUB për vitin 2012”, u konstatua se një operator ofertues ka paraqitur dokumentacion i cili është më i hershëm se kufiri 3 mujor i vendosur në kriteret e përgjithshme, ndërsa në 1 (një) rast tjetër i njëjti operator ka paraqitur dokumentacion pa datë, në kundërshtim me DST.

-Në tenderin “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për vitin 2013, të 3 (tre) objekteve të UK Shkodër”, KVO ka s`kualifikuar një operator ekonomik, pa e argumentuar në mënyrë të saktë si dhe në kundërshtim me DST pasi nuk përbënte kriter s`kualifikues, duke anuluar procedurën e tenderimit. Por në procedurën e dytë KVO, e ka kualifikuar këtë operator, edhe pse nuk ka ndryshuar asgjë në dokumentacionin e paraqitur, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-24, 25-30, 37-47 dhe 60-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 2, 4, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe Aktverifikimet nr. 2,3, 4, datë 30.09.2014)

4. [REDAKTUAR], me detyrë Shefe e Departamentit të Ujësjiellësit, pasi:

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka hartuar si dhe nuk ka dërguar për miratim tek Këshilli Mbikqyrës, programe ekonomiko-financiare vjetore.

-U konstatuan diferenca në mënyrën e llogaritjes së prodhimit të ujit ndërmjet departamentit të ujësjiellësit dhe departamentit të planifikimit. Nga këto diferenca, rezultoi se për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, ka raportuar më pak 12,724,199 m³ ujë, si dhe ka raportuar normën e humbjeve teknike në vlerën 11% më pak, e cila duhet të jetë 79% dhe jo 68% e raportuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës e Kanalizime (DPUK) dhe Institutin e Statistikave (INSTAT).

-Në tenderin “Blerje dhe furnizim me Kapakë Gize” nga KVO u konstatua se një operator ofertues nuk kishte paraqitur ofertë ekonomike, ndërsa nga auditimi i procedurës elektronike, rezultoi se ky operator kishte paraqitur ofertë, por që nuk ka efekt financiar pasi ishte më e lartë se oferta fituese.

-Në tenderin “Blerje dhe furnizim me Eurodiesel i sektorit KUB për vitin 2012”, u konstatua se një operator ofertues ka paraqitur dokumentacion i cili është më i hershëm se kufiri 3 mujor i vendosur në kriteret e përgjithshme, ndërsa në 1 (një) rast tjetër i njëjti operator ka paraqitur dokumentacion pa datë, në kundërshtim me DST.

-Në tenderin “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për vitin 2013, të 3 (tre) objekteve të UK Shkodër”, KVO ka s`kualifikuar një operator ekonomik, pa e argumentuar në mënyrë të saktë si dhe në kundërshtim me DST pasi nuk përbënte kriter s`kualifikues, duke anuluar procedurën e tenderimit. Por në procedurën e dytë KVO, e ka kualifikuar këtë operator, edhe pse nuk ka ndryshuar asgjë në dokumentacionin e paraqitur, në kundërshtim me Ligjin nr.

9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-24 dhe 33-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 2, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13 datë 30.09.2014)

Neni 11, paragrafi 2 “Vërejtje me shkrim”

Për,

1. ████████, me detyrë Shef i Departamentit të Task-Forcës, pasi:

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka hartuar si dhe nuk ka dërguar për miratim tek Këshilli Mbikqyrës, programe ekonomiko-financiare vjetore.

-Nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur institucionale uljes së debitorëve e cila në vitin 2013 është rritur në vlerën 209,531,185 lekë, si dhe për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, nuk ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër asnjë kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ndaj subjekteve debitore, në kundërshtim me Ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-24 dhe 30-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 2 dhe Aktverifikimin nr. 3, datë 30.09.2014)

2. ████████, me detyrë Shefe e Departamentit Juridik, pasi:

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka hartuar si dhe nuk ka dërguar për miratim tek Këshilli Mbikqyrës, programe ekonomiko-financiare vjetore.

-Të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, nuk janë të miratuara në programin ekonomiko-financiar të vitit 2012, për shkak se për vitet 2012, 2013 dhe 2014, nuk janë hartuar programe ekonomiko-financiare, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

-Nuk përcaktohet qartë mënyra e llogaritjes së fondit limit. Studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse apo kontratat e mëparshme të vetë shoqërisë. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, si dhe në disa raste ato kanë qenë të sforcuara. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet operatorët ekonomikë fitues, i kanë sjellë dokumentet dorazi dhe të paprotokolluara apo arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22 “Format e Komunikimit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-24 dhe 37-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 2, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, datë 30.09.2014)

3. ████████, me detyrë Shefe e Departamentit të Kanalizime Ujëra të Zeza (KUZ), pasi:

-Për vitin 2012 nuk ka kryer procedurën e inventarizimit, në kundërshtim me Urdhrin nr. 3 datë 03.01.2012 të Drejtorit të UK Shkodër.

-Të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, nuk janë të miratuara në programin ekonomiko-financiar të vitit 2012, për shkak se për vitet 2012, 2013 dhe 2014, nuk janë hartuar programe ekonomiko-financiare, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

-Nuk përcaktohet qartë mënyra e llogaritjes së fondit limit. Studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse apo kontratat e mëparshme të vetë shoqërisë. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, si dhe në disa raste ato kanë qenë të sforcuara. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet operatorët ekonomikë fitues, i kanë sjellë dokumentet dorazi dhe të paprotokolluara apo arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22 “Format e Komunikimit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-24 dhe 33-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 2, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, datë 30.09.2014)

4. ████████, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes, pasi:

-Në tenderin “Blerje dhe furnizim me Eurodiesel i sektorit KUB për vitin 2012”, u konstatua se një operator ofertues ka paraqitur dokumentacion i cili është më i hershëm se kufiri 3 mujor i vendosur në kriteret e përgjithshme, ndërsa në 1 (një) rast tjetër i njëjti operator ka paraqitur dokumentacion pa datë, në kundërshtim me DST.

-Në tenderin “Blerje dhe furnizim me Kapakë Gize” nga KVO u konstatua se një operator ofertues nuk kishte paraqitur ofertë ekonomike, ndërsa nga auditimi i procedurës elektronike, rezultoi se ky operator kishte paraqitur ofertë, por që nuk ka efekt financiar pasi ishte më e lartë se oferta fituese.

-Për vitin 2012 nuk ka kryer procedurën e inventarizimit, në kundërshtim me Urdhrin nr. 3 datë 03.01.2012 të Drejtorit të UK Shkodër.

-Të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën 01.06.2012-30.06.2014, nuk janë të miratuara në programin ekonomik-financiar të vitit 2012, për shkak se për vitet 2012, 2013 dhe 2014, nuk janë hartuar programe ekonomik-financiare, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

-Nuk përcaktohet qartë mënyra e llogaritjes së fondit limit. Studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse apo kontratat e mëparshme të vetë shoqërisë. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, si dhe në disa raste ato kanë qenë të sforcuara. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet operatorët ekonomikë fitues, i kanë sjellë dokumentet dorazi dhe të paprotokolluara apo arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22 “Format e Komunikimit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-57, 41-51 dhe 57-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 8, 9, 10, 14, Aktverifikimin nr. 4, datë 30.09.2014)

III. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese, ligjzbatuese, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore “Largim nga detyra” në vartësi të përgjegjësisë së konstatuar për:

1. ████████, në cilësinë e Drejtores në detyrë e SHA Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër për periudhën 01.06.2012-15.04.2013;

(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Meqënëse ████████ nuk është në marrëdhënie pune, masën e propozuar e konsiderojmë të ezauruar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Alfonc Gabili, Skënder Muça dhe Valdete Berisha, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT